



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

BASHKIA ELBASAN  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2193/1 Prot

Dt. 29.04.2026

**V E N D I M**

Nr. 56 datë 28.04.2026

**"PËR MIRATIMIN E THEMELIMIT TE SHOQËRISE TREGTARE "ERE" SH.A, SI PERSON JURIDIK NE PRONËSI TË BASHKISË ELBASAN DHE MIRATIMIN E AKTEVE TË THEMELIMIT"**

Këshilli bashkiak pasi shqyrtoj materialin e paraqitur nga administrata e bashkisë në lidhje me Miratimin e themelimit te shoqërisë tregtare "ERE" sh.a, si person juridik ne pronësi të bashkisë Elbasan dhe miratimin e akteve të themelimit, në mbështetje të bazës ligjore të mëposhtëme:

- Në mbështetje të ligjit nr.139 /2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar;
- Ligjit nr. 57, datë 30.04.2020 "Për Pyjet ", i ndryshuar;
- Ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare". i ndryshuar, të neneve 26, 28, 32 e 36
- Ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për regjistrimin e biznesit". i ndryshuar,
- Ligji nr.9734, date 14.05.2007 "Për Turizmin",.

**V E N D O S I**

1. Krijimin e shoqërisë tregtare "ERE" sha, në formën e shoqërisë tregtare aksionare, me objekt objekt ushtrimin e veprimtarive ekonomike në funksion të zhvillimit rural, mjedisor dhe agroturistik.
2. Miratimin e aktit të themelimit dhe statutit te shoqërisë " ERE "sha.a si dhe të ngarkojë Kryetarin e Bashkisë ose personin e autorizuar prej tij, që të nënshkruaj aktet e themelimit të kësaj shoqërie tregtare.
3. Shoqëria " ERE " sh.a, themelohet, organizohet dhe funksionon si shoqëri me aksione, në përputhje me parashikimet e ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar.
4. Kapitali fillestar për krijimin e shoqërisë " ERE " sha do të jetë 5.000.000 (pesë milion) lekë.
5. Transferimin e fondit 5,000.000 lekë, në buxhetin e vitit 2026, nga DPKS, funksioni 08230, artikulli 602 "Festat e Njësisve Administrative", në funksionin 04220, artikulli 604, institucioni Bashkia, për financimin e pikës 4, të këtij vendimi.
6. Bashkia Elbasan është ortaku i vetem themelues, i cili zotëron 100% te kapitalit themeltar te shoqërisë "ERE ".
7. Shoqëria " ERE " sha, te ketë selinë qendrore në adresën.", Rruga Qemal Stafa (Godina e Bashkisë).
8. Shoqëria "ERE "sha, të zhvillojë aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar.
9. Bashkia Elbasan, brenda 15 (pesëmbdhjete ) diteve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, ndjek procedurat e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë " ERE "sha.
10. Shoqëria " ERE " sha, në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së saj, ka të drejtë të shqyrtojë dhe të vlerësojë mundësinë e bashkëpunimit me shoqëritë e tjera tregtare dhe të hyje në marrënie kontraktuale me persona te tretë.
11. Të autorizojë kryetarin e Bashkisë ose personin e deleguar prej tij që të përfaqësojë Bashkinë Elbasan, në cilësinë e aksionarit të vetëm përkryrjen e të gjitha veprimtarive të nevojshme për përgatitjen dhe nënshkrimin të akteve të themelimit të shoqërisë së re dhe regjistrimin e saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

12. Bashkia Elbasan i siguron shoqerise "ERE " sha, nga inventari i saj i pronave të paluajtshme apo ambiente të tjera të kontraktuara ndaj të tretëve, mjediset e nevojshme për fillimin e ushtrimit të veprimtarisë sipas objektit të saj.
13. Bashkëngjitur relacioni shpjegues.
14. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
15. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore").

**Sekretari i Këshillit Bashkiak**

Elsid Zyma

Konceptoi: L.Baho

Pranoi: L.Haxhiymeri

Miratoi: Sh.Çullhaj

Nenkryetar: A.Sula

D. Finances: A.Merkja

D.Juridike : A.Hoxha

**KRYETAR**

Lutfi Lala

Miratuar me 37 vota

Vota Pro 29

Vota Kundër 4

Vota Abstenim 2

Zbardhur me datë 29/04. 2026.